



WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE
ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA
REGULATORNI URED ZA VODU I OTPAD

**ZYRA RREGULATORE PËR UJËSJELLËS DHE MBETURINA (“ZRRUm”)
(R-02/M)**

**RREGULLA
PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT
PËR
SHËRBIMET E GRUMBULLIMIT DHE DEONIMIT TË MBETURINAVE
NË KOSOVË**

12 Gusht 2008

PËRMBATJA

PJESA I : DISPOZITAT E PËRGJITHSHME.....	5
KAPITULLI 1 : AUTORITETI, FUSHËVEPRIMI, QËLLIMI DHE PËRKUFIZIMET	5
Neni 1 Autoriteti për këtë Rregull.....	5
Neni 2 Fushëveprimi	5
Neni 3 Qëllimi	5
Neni 4 Përkufizimet	5
Neni 5 Rregullat e Interpretimit.....	8
Neni 6 Aplikueshmëria.....	9
PJESA II : PARIMET E PËRGJITHSHME PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE.....	9
KAPITULLI 2 : PARIMET E PËRGJITHSHME	9
Neni 7 Parimet e Përgjithshme për Tarifave të Shërbimeve.....	9
Neni 8 Aplikueshmëria e Tarifave të Shërbimeve brenda Zonës së Shërbimit	10
Neni 9 Kategoritë e Konsumatorëve për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimeve.....	10
KAPITULLI 3 : METODA PËR PËRLOGARITJEN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT	11
Neni 10 Metodën Përlogaritëse të Tarifave të Shërbimeve.....	11
Neni 11 Përcaktimi i Tarifave të Shërbimit	11
PJESA III : LLOGARITJA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT ME ANË TË METODËS SË MBULIMIT TË KOSTOS.....	12
KAPITULLI 4 : PËRMBLEDHJE E PROCEDURAVE TË LLOGARITJES SË TARIFAVE TË SHËRBIMIT	12
Neni 12 Hapat për Llogaritjen e Tarifave të Shërbimit për Shërbimet e Mbeturave	12
KAPITULLI 5 : VLERËSIMI I SASISË SË PROJEKTUAR TË MBETURINAVE QË DUHET TË PROCESOHEM.....	12
Neni 13 Vlerësimi i sasisë së projektuar të mbeturave që duhet të procesohet	12
KAPITULLI 6 : VLERËSIMI I KOSTOVE TOTALE TË PROJEKTUARA VJETORE TË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE	12
Neni 14 Komponentët e kostove të ofrimit të shërbimeve	12
Neni 15 Llogaritja e Kostove Operative.....	13
Neni 16 Kostot që përjashtohen nga Përlogaritja e Kostove Operative.....	13
Neni 17 Kostot e Shërbimit të Borxhit	14
Neni 18 Llogaritë e Arkëtueshme të Pa-mbledhshme	14
Neni 19 Shpenzimet Kapitale	15
Neni 20 Përmbledhja e Kostove.....	15
Neni 21 Aktivitetet e Parregulluara	15
Neni 22 Subvencionet dhe Grantet.....	15
KAPITULLI 7 : VLERËSIMI I TË HYRAVE TË NEVOJSHME NGA OPERIMET	16
Neni 23 Vlerësimi i Të Hyrave të Nevojshme nga Operimet	16
KAPITULLI 8 : PËRKUFIZIMI I STRUKTURËS SË TARIFAVE TË SHËRBIMIT QË I PROPOZOHET RREGULLATORIT	16
Neni 24 Kalkulimi i të Hyrave të Vlerësuara.....	16
KAPITULLI 9 : KONFIRMIMI QË TË HYRAT E VLERËSUARA NGA OPERIMET DO TË JENË TË MJAFTUESHME PËR MBULIMIN E KOSTOVE TË VLERËSUARA PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE	16
Neni 25 Konfirmimi i mjaftueshmërisë së të hyrave e vlerësuara për të mbuluar kostot e vlerësuara për ofrimin e shërbimeve	16
PJESA IV : SHQYRTIMI DHE APROVIMI I APLIKACIONEVE PËR TARIFA TË SHËRBIMIT.....	17
KAPITULLI 10 : APLIKIMI PËR TARIFA TË SHËRBIMIT, SHQYRTIMI DHE APROVIMI NGA RREGULLATORI	17
Neni 26 Aplikimi për Tarifa të Shërbimit.....	17
Neni 27 Shqyrtimi i Aplikacionit të Tarifave të Shërbimit nga ana e Rregullatorit.....	17
Neni 28 Aprovimi i Tarifave të Shërbimit	17
PJESA V : KOHËZGJATJA, KORRIGJIMI DHE RISHIKIMI I TARIFAVE TË SHËRBIMIT.....	18
KAPITULLI 11 : KOHËZGJATJA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT	18
Neni 29 Kohëzgjatja e Tarifave të Shërbimit.....	18
KAPITULLI 12 : KORRIGJIMET E TARIFAVE TË SHËRBIMIT.....	18
Neni 30 Kërkesat për Korrigjimin e Tarifave të Shërbimit.....	18
Neni 31 Aprovimi i Procedurave për Korrigjimin e Tarifave të Shërbimeve	19

Neni 32 Refuzimi i Korrigjimit të Tarifave të Shërbimit.....	19
KAPITULLI 13 : SHQYRTIMI I TARIFAVE TË SHËRBIMIT	20
Neni 33 Rishikimi i Tarifave shumëvjeçare të Shërbimit.....	20
PJESA VI : MARRËVESHJET PËR TARIFA TË SHËRBIMEVE.....	21
KAPITULLI 14 : NEGOCIMI DHE LIDHJA E MARRËVESHJES PËR TARIFA TË SHËRBIMEVE.....	21
Neni 34 Marrëveshja për Tarifa të Shërbimeve.....	21
Neni 35 Negociatat e Marrëveshjes për Tarifa të Shërbimit.....	21
Neni 36 Lidhja e Marrëveshjes për Tarifat e Shërbimit.....	22
KAPITULLI 15 : NATYRA LIGJORE DHE ZBATUESHMËRIA E MARRËVESHJES PËR TARIFA TË SHËRBIMEVE	22
Neni 37 Natyra Ligjore dhe Zbatueshmëria e Marrëveshjes për Tarifa të Shërbimeve	22
Neni 38 Respektimi i Marrëveshjes për Tarifat e Shërbimeve	23
PJESA VII : PUBLIKIMI I TARIFAVE TË SHËRBIMIT	23
KAPITULLI 16 : PREZANTIMI DHE PUBLIKIMI I TARIFAVE TË SHËRBIMIT	23
Neni 39 Prezantimi i Tarifave të Shërbimit	23
Neni 40 Publikimi dhe Shpërndarja e Tarifave të Shërbimit	23
PJESA VIII : ZBATIMI, DËNIMET DHE ANKESAT	24
KAPITULLI 17 : ZBATIMI I KUSHTEVE TË TARIFAVE TË SHËRBIMEVE	24
Neni 41 Zbatimi i Kushteve të Tarifave të Shërbimeve	24
KAPITULLI 18 : SHËNIMET DHE RAPORTET E KUSHTEVE PËR TARIFAT E SHËRBIMIT	24
Neni 42 Vendi dhe Disponueshmëria e Shënimeve	24
Neni 43 Raportet.....	24
Neni 44 Periudha e Mbajtjes së Shënimeve dhe Raporteve	25
KAPITULLI 19 : KUNDËRVAJTJET DHE DËNIMET	25
Neni 45 Kundërvajtjet, Dënimet dhe Gjobat.....	25
KAPITULLI 20 : ANKESAT	25
Neni 46 Ankesat	25
PJESA IX : TË NDRYSHME.....	26
Neni 47 Gjuhët.....	26
Neni 48 Hyrje në Fuqi	26
PJESA X : SHTOJCAT	27
SHTOJCA 1 FORMULARI I APLIKIMIT PËR TARIFAT E SHËRBIMIT PËR SHËRBIMET E MBETURINAVE.....	28
SHTOJCA 29 DOKUMENTET E NEVOJSHME QË DUHET TË BASHKANGJITEN NGA APLIKUESI PËR TARIFA TË SHËRBIMIT DHE INSTRUKSIONET	29
SHTOJCA 3 KËRKESA PËR KORRIGJIM TË TARIFAVE	31

PJESA I : DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Kapitulli 1 : Autoriteti, Fushëveprimi, Qëllimi dhe Përkufizimet

Neni 1 Autoriteti për këtë Rregull

Rregullatori nxjerr këtë Rregull nën autoritetin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/49 *Mbi Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe Mbeturinave* të datës 26 Nëntor dhe amendamenteve të bëra me *Ligjin Nr. 03/L-086* të aprovuar më 13 Qershor 2008.

Neni 2 Fushëveprimi

Të gjithë Ofruesit e Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave dhe Ofruesit e Shërbimeve të Deponimit të Mbeturinave në Kosovë duhet t'i përmbahen kësaj Rregulle për të zhvilluar, marrë aprovimin, dhe për të kërkuar ndryshime në Tarifat e Shërbimeve me të cilat faturohen Konsumatorët për ofrimin e Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave dhe Shërbimeve të Deponimit të Mbeturinave.

Neni 3 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulle është të mundësojë vendosjen e Tarifave të Shërbimeve për Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave sipas principeve ekonomike duke marrë parasysh nevojën për të siguruar qëndrueshmërinë financiare të Ofruesve të Shërbimeve të Mbeturinave dhe vazhdimësinë e Shërbimeve të Mbeturinave, në nivelin e vendosur në Rregullën mbi Standardet e Shërbimeve.

Neni 4 Përkufizimet

Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë Rregull do të përmbajnë kuptimet si në vijim:

Amortizimi i Granteve nënkupton amortizimin negativ të granteve kapitale të ofruara nga donatorët e jashtëm të cilat duhet të përfshihen në të hyrat vjetore, nëse kërkohet të bëhet amortizimi i aseteve të financuara përmes granteve për qëllimet tarifore;

Aplikacioni për Tarifat e Shërbimit nënkupton të dhënat dhe dokumentacionin e dorëzuar nga Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave, me qëllim të marrjes së aprovimit nga Rregullatori për aplikimin e Tarifave të propozuara të Shërbimit për ofrimin e Shërbimeve të Mbeturinave;

Asetet Fikse nënkupton asetet e natyrës afatgjatë të cilat kërkohen për ushtrimin normal të afarizmit dhe të cilat normalisht nuk do të shndërohen në para të gatshme (kesh) gjatë periudhës përkatëse fiskale;

Borxhet e Vjetra nënkupton të gjitha borxhet që kanë të bëjnë me grumbullimin e mbeturinave të një Konsumatori, të evidentuara nga faturat e pakontestuara, të lëshuara nga Ofruesi Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave tek ai Konsumator me apo para 31 dhjetor 2002 dhe të cilat nuk janë paguar tërësisht, ashtu siç definohet në Rregullën mbi Borxhet e Vjetra të lëshuar nga Rregullatori;

Ditë Pune nënkupton cilëndo ditë përveç të shtunës dhe të dielës, apo një dite tjetër që është festë zyrtare në Kosovë;

Fatura nënkupton dokumentin që dërgohet tek Konsumatori i cili specifikon shërbimet e ofruara dhe/ose mallrat e pranuar, Tarifat e zbatueshme të Shërbimeve, çmimet e tyre ose taksat e zbatueshme, çfarëdo taksa dhe/ose ngarkesa tjera zyrtare dhe/ose pagesat zyrtare të ngarkuara për ofrimin e shërbimeve të tilla dhe/ose mallrat dhe shumën

totale të parave që i ka borxh Konsumatori. Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave mund të vendos vet dhe/ose nëse kërkohet me ligj dhe/ose përcaktohet nga Rregullatori që kohë pas kohe të përfshijë në të edhe informacione shtesë.

Festë Zyrtare nënkupton cilëndo ditë që njihet ose e përcaktuar nga autoritetet qeveritare si ditë që nuk punohet;

Jetëgjatësia Ekonomike e Shfrytëzimit nënkupton periudhën kohore të shprehur në vite ose pjesët nga kjo në të cilën një Aset Fiks mund të përmbushi shfrytëzimin e menduar në mënyrë adekuate dhe ekonomikisht të përshtatshme;

Karta e Konsumatorit nënkupton dokumentin e shkruar të përgatitur nga Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave dhe që i është vënë në dije secilit Konsumator në të cilin përfshihen të drejtat dhe obligimet e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe të Konsumatorëve që kanë ndaj njëri tjetrit;

Komisioni Shqyrtues nënkupton komisionin i cili mund të rishikojë vendimet e Rregullatorit në pajtim me Nenin 34 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/49 *Mbi Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe të Mbeturinave* të amendamentuar me *Ligjin Nr. 03/L-086* të datës 13 qershor 2008;

Konsumator Institucional nënkupton cilindo subjekt ligjor të klasifikuar nga Ofruesi i Shërbimeve si autoritet qeveritar, autoritet lokal, organizatë ndërkombëtare apo institucion i cili kryen veprimtaritë të interesit të përbashkët apo publik dhe i cili nuk është i regjistruar si organizatë afariste në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare Nr. 02/L-123;

Konsumator Komerical/Industrial nënkupton cilindo person, subjekt ligjor ose organizatë afariste të klasifikuar nga Ofruesi i Shërbimeve si Konsumator i cili shfrytëzon Shërbimet për apo në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë industriale apo komerciale;

Konsumator Shtëpiak nënkupton Konsumatorin e klasifikuar nga Ofruesi i Shërbimeve si person i cili shfrytëzon Shërbimet në banesën ose amvisërinë e tij apo saj;

Konsumator nënkupton një Person, që ka lidhë Kontratë Shërbimi me një Ofrues të Shërbimeve të Mbeturinave ose që ka marrë shërbime të ofruara nga Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave;

Kontejnerët Komunal nënkupton kontejnerët që shfrytëzohen nga një ose më shumë Konsumatorë për të hedhur Mbeturinat e Ngurta Komunale dhe të cilët kanë një vëllim tipik që tejkalon njëmijë (1,000) litra;

Kontrata e Shërbimit nënkupton marrëveshjen në mes të Ofruesit të Shërbimeve dhe Konsumatorëve të tij që i referohet Nenit 15 të Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 *Mbi Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe Mbeturinave* të amendamentuar me *Ligjin Nr. 03/L-086* të datës 13 qershor 2008;

Kostot kapitale nënkupton kostot e tilla si amortizimi i aseteve fikse;

Kostot Operative nënkupton kostot e rregullta që përsëriten si shpenzimet administrative, interesi në borxhe dhe ngarkesat financiare, pagat, shpenzimet e transportit dhe karburanteve, inventarit dhe pjesëve rezervë dhe shpenzimet e rregullta të mirëmbajtjes të nevojshme për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e aseteve fikse, me qëllim që të arrihet kapaciteti dhe performanca për të cilat janë projektuar dhe ndërtuar dhe që janë paraparë për një periudhë prej një viti ose më pak ;

Licenca e Shërbimit nënkupton licencën e lëshuar nga Rregullatori në pajtim me Rregullën e nxjerrë nga Rregullatori, që autorizon Ndërmarrjet Publike ose Shoqërore të ofrojnë Shërbimet të Mbeturinave për publikun;

- Llogaritë e Arkëtueshme** nënkupton asetet e tanishme që paraqesin borxhin në para ndaj Ofruesit e Shërbimeve Mbeturinave për shërbimet e ofruara apo të kryera apo për mall të shitur me kredi;
- Marrëveshje për Tarifat e Shërbimit** nënkupton marrëveshjen që mund të lidhet në mes të Rregullatorit dhe Ofruesit të Shërbimeve të Mbeturinave për të korigjuar, modifikuar, ndryshuar dhe/apo për të plotësuar cilatdo Tarifa të Shërbimit, në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulle;
- Mbeturinat e Ngurta Komunale** nënkupton mbeturinat e ngurta që nuk janë mbeturina të rrezikshme ose mbeturinat mjekësore që burojnë nga Amvisëritë, veprimtaria Komerciale, Industriale apo Institucionale, dhe mbeturinat e procesuara;
- Mbeturinat e Rrezikshme** nënkupton nus produkte të shoqërisë që mund të paraqesin rrezik të dukshëm ose rrezik të mundshëm për shëndetin njerëzor ose mjedisin kur ato menaxhohen në mënyrë të gabueshme. Substancat e klasifikuara si Mbeturina të Rrezikshme posedojnë së paku njërën prej katër karakteristikave në vazhdim: ndezshmërinë, korrozionin, reaktivitetin apo helmueshmërinë ose janë klasifikuar si të rrezikshme nga Bashkimit Evropian;
- Mbeturinat Mjekësore** nënkupton çdo mbeturinë që ka origjinë nga një vend apo aktivitet ku jepet përkujdesje mjekësore dhe përfshinë mbeturinat e produkteve infektive, anatomike, të mprehta, kimike dhe farmaceutike;
- Mbulimi i Kostos** nënkupton mbulimin përmes Tarifave të Shërbimit të kostove operative dhe të mirëmbajtjes për Shërbimet e ofruara të Mbeturinave, së bashku me cilat do plane të shpenzimeve kapitale të Ofruesit të Shërbimeve që janë aprovuar nga Rregullatori;
- Ndërmarrje Publike** nënkupton ndërmarrje të përshkruara në Ligjin për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 të datës 13 qershor 2008;
- Ofruesi i Shërbimeve të Deponimit të Mbeturinave** nënkupton cilindo Person që ofron apo ka për qëllim të ofrojë Shërbimet e Deponimit të Mbeturinave;
- Ofruesi i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave** nënkupton secilin Person që ofron apo ka për qëllim të ofrojë Shërbime të Grumbullimit të Mbeturinave;
- Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave** nënkupton secilin Person që ofron apo ka për qëllim të ofrojë Shërbime për Grumbullimin e Mbeturinave dhe/ose Shërbime për Deponimin e Mbeturinave;
- Personi** nënkupton një individ, entitet ligjor apo publik përfshirë korporatë, ortakëri, trust, një organizatë të jo-inkorporuar, qeveri apo agjenci ose nën-sektor;
- Plani i Konsolidimit** nënkupton Planin e Ristrukturimit të Sektorit që është krijuar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (“AKM”) për konsolidimin dhe ristrukturimin e Ofruesve të Shërbimeve të Mbeturinave të datës 10 shtator 2002, e ndryshuar, plotësuar apo zëvendësuar kohë pas kohe nga ana e AKM-së;
- Plani për Menaxhimin e Aseteve** nënkupton planin e shkruar që përcakton dhe arsyeton nevojën për projekte specifike dhe shpenzimet kapitale dhe investimet e nevojshme për të realizuar ato projekte dhe intervalin kohor në të cilin ato shpenzime ose investime bëhen ose kërkohet të kryhen;
- Provizioni për Llogaritë e Arkëtueshme të Pa-mbledhshme** nënkupton një shumë të vlerësuar të ofruar në llogaritë që ka të bëjë me borxhet që pritet të mos arkëtohen;

Rregullatori nënkupton autoritetin përgjegjës për rregullimin ekonomik të Ofruesve të Shërbimeve të Mbeturinave që është Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Mbeturina ("ZRRUM") e themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/49 *Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe Mbeturinave* të amendamentuar me *Ligjin Nr. 03/L-086* të datës 13 qershor 2008;

Shërbimet e Deponimit të Mbeturinave nënkupton menaxhimin e objekteve të licencuara në të cilat Ofruesit e Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave mund ti sjellin mbeturinat e ngurta komunale për Deponim;

Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave nënkupton grumbullimin e mbeturinave të ngurta komunale dhe transportimin e tyre në objektin e licencuar për deponim;

Shërbimet e Mbeturinave nënkupton Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave dhe/ose Shërbimet e Deponimit të Mbeturinave.

Shpenzimet Kapitale nënkupton shpenzimet që paraqiten në lidhje me investimet në asetet fikse me jetëgjatësi e cila tejkalon një vit, përfshirë, pa kufizime, shpenzimet që llogaritet të amortizohen apo zhvlerësohen gjatë jetëgjatësisë së cilido aset fiks të caktuar, të klasifikuar si pronë, impiant apo pajisje;

Standardet e Shërbimit nënkupton në lidhje me cilindo shërbim, standardet e shërbimit që zbatohen për atë shërbim në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/49 *Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe Mbeturinave* të amendamentuar me *Ligjin Nr. 03/L-086* të datës 13 qershor 2008;

Tarifa e Shërbimit nënkupton çdo vlerë, çmim apo taksë të Ofruesit të Shërbimeve të Mbeturinave në lidhje me ofrimin e Shërbimeve të Mbeturinave të Konsumatorët e vet;

Të Hyrat nga Operimet nënkupton vlerën totale të faturuar për mbulimin e shpenzimeve për ofrimin e Shërbimeve të Mbeturinave të llogaritur në përputhje me këtë Rregull;

Urdhëresa për Tarifat e Shërbimit nënkupton dokumentin me shkrim të lëshuar nga Rregullatori që përfshinë të gjitha Tarifat e aprovuara të Shërbimit sipas llojit, vendndodhjes, dhe kategorisë së Konsumatorëve;

Vendbanim nënkupton çdo shtëpi, banesë, vendbanim shumë-bloqesh, ndërtesë apartamenti, shtëpi apo ndonjë ndërtesë tjetër të përdorur për qëllime banimi;

Vlera e Mbetur nënkupton diferencën në mes kostove historike bruto të aseteve të caktuara fikse minus i tërë zhvlerësimi i akumuluar deri në fund të jetëgjatësisë së tyre të dobishme ekonomike;

Zhvlerësimi nënkupton metodën e shpërndarjes së kostove të shpenzimeve kapitale gjatë jetëgjatësisë së dobishme ekonomike të cilido aset fiks të dhënë;

Zona e Shërbimit nënkupton, në lidhje me Licencën e Shërbimit, rajonin apo komunën brenda së cilës Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave mund të ofrojë shërbimet e veta;

Neni 5 Rregullat e Interpretimit

Në këtë Rregull:

- (a) Cilat do fjalë dhe shprehje të përdorura në këtë Rregull, që nuk janë veçanërisht të definuara këtu dhe të cilat mund të jenë të paqarta, do të përmbajnë kuptimet siç janë të përcaktuara në aktet ligjore të referuara në këtë Rregull dhe/ose në cilindo tjetër ligj të aplikueshëm në Kosovë; dhe

- (b) Referencat në Rregull do të interpretohen sipas kuptimit të cilëndo Rregull të lëshuar, të modifikuar, ndryshuar, plotësuar, dhe/ose të zëvendësuar nga Rregullatori kohë pas kohe në pajtim me pushtetin që i është dhënë Rregullatorit; dhe
- (c) Njëjësi përfshinë shumësin dhe anasjelltas; dhe
- (d) Fjalët që përdoren në cilëndo gjini do të përfshijnë cilëndo gjini tjetër; dhe
- (e) Referencat për Pjesët, Kapitujt, Nenet dhe nën-Nenet, përveç nëse shprehimisht nuk caktohet ndryshe, janë referenca për Pjesë, Kapituj, Nene dhe nën-Nene të kësaj Rregulle.

Neni 6 Aplikueshmëria

Nga të gjitha ndërmarrjet publike që ofrojnë Shërbime të Mbeturinave kërkohet të ofrojnë Shërbime të tilla me Tarifat e Shërbimit, të përcaktuara në pajtim me kërkesat e kësaj Rregulle, të dorëzuara dhe të aprovuara nga Rregullatori para aplikimit të tyre, përveç nëse Ofruesit e Shërbimeve nuk janë liruar në mënyrë specifike, me shkrim, nga Rregullatori për ta bërë një gjë të tillë.

PJESA II : PARIMET E PËRGJITHSHME PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE

Kapitulli 2 : Parimet e Përgjithshme

Neni 7 Parimet e Përgjithshme për Tarifat e Shërbimeve

- (a) Jo-Diskriminimi: Ofruesi i Shërbimeve duhet të veprojë në atë mënyrë që nuk do të diskriminojë në mënyrë të paligjshme asnjë Konsumator ose Konsumator të mundshëm pa marrë parasysh karakteristikat racore, etnike, religjioze, politike, kulturore dhe/ose ekonomike ose standardet përkatëse të jetesës të atyre Konsumatorëve në cilëndo Zonë të Shërbimit të caktuar;
- (b) Balancimi: Tarifat duhet të balancohen në mes standardeve minimale të shërbimeve, qëndrueshmërisë financiare të Ofruesve të Shërbimeve dhe mundësisë paguese të Konsumatorit;
- (c) Mbulimi i Kostos: Tarifat duhet të prodhojnë burime financiare të nevojshme për Ofruesin e Shërbimeve, me kusht të operimit eficient, që të mbulojë kostot e tija të operimit dhe të mirëmbajtjes, kostot përgjithshme të arsyeshme dhe tepicën e nevojshme për financimin e shpenzimeve kapitale;
- (d) Shfrytëzuesi Pagan (Barazia e Konsumatorëve): Çdo konsumator duhet të faturohet me koston e plotë në lidhje me ofrimin e Shërbimeve të Mbeturinave. Konsumatori duhet të bëjë pagesën në tërësi dhe me kohë. Dështimi i pagesës rezulton me dënime financiare;
- (e) Drejtësia Sociale: Struktura tarifore duhet të reflektojë drejtësinë dhe korrektësinë e shërbimit dhe të vendosjes së çmimeve. Rregullorja 2004/49, Neni 10.3 (f) thotë që “është përgjegjësi e Institucioneve të Përkohshme të Vetqeverisjes e jo e Ofruesve të Shërbimeve që të ndihmojë Konsumatorët me të ardhura të ulëta të paguajnë faturat e tyre.

- (f) Performanca e Ofruesit të Shërbimeve: Ofruesit e Shërbimeve nuk duhet të kenë kompensim përmes tarifave për performancën joefikase dhe joefiçente të detyrave të tyre.

Neni 8 Aplikueshmëria e Tarifave të Shërbimeve brenda Zonës së Shërbimit

- 8.1 Ofruesit e Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave duhet të përdorin Tarifat e njëjta të Shërbimit në tërë Zonën e Shërbimit për llojin e njëjtë të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave, përveç nëse ndryshe autorizohen nga ana e Rregullatorit.
- 8.2 Një Ofrues i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave mund të kërkojë autorizimin me shkrim nga Rregullatori për të përdorë Tarifat e ndryshme të Shërbimit brenda Zonës së Shërbimit duke ofruar arsyet për një kërkesë të tillë. Brenda njëzet (20) ditëve të punës nga data kur pranohet ajo kërkesë, Rregullatori duhet të jep përgjigjen me shkrim nëse pajtohet ose refuzon të bëjë një gjë të tillë duke i ofruar arsyet.

Neni 9 Kategoritë e Konsumatorëve për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimeve

- 9.1 Më qëllim të përcaktimit të Tarifave të Shërbimeve për Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave, kategoritë e Konsumatorëve duhet të kufizohen në:
- (a) Konsumatorë Shtëpiak;
 - (b) Konsumatorë Komercial/Industrial;
 - (c) Konsumatorë Institucional.
- 9.2 Secila prej kategorive të Konsumatorëve të përfshira në nën-nenin 9.1 të lartë shënuar do të nën-ndahet si në vijim :
- (a) Tarifat e Shërbimeve për Konsumatorët Shtëpiak duhet të ndahen në dy(2) nën-kategori, si në vijim:
 - (i) Konsumatorët Shtëpiak që marrin shërbimet përmes metodës së Kontejnerëve Komunal duhet të faturohen me tarifë fikse mujore që pasqyron shpenzimet e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave të cilat ofrohen në këtë mënyrë;
 - (ii) Konsumatorët Shtëpiak që marrin Shërbimet individuale për Grumbullimin e Mbeturinave nëpërmes të metodës shtëpi-për-shtëpi duhet të faturohen me vlerë fikse mujore që pasqyron shpenzimet e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave që ofrohen në këtë mënyrë;
 - (b) Tarifat e Shërbimeve për Konsumatorët Komercial/Industrial do të ndahen në dy (2) nën-kategori, respektivisht:
 - (i) Konsumatorët Komercial që marrin shërbimet nëpërmes të metodës së Kontejnerëve Komunal në të cilin Kontejneri Komunal shfrytëzohet edhe nga Konsumatorët tjerë, duhet të faturohen me tarifë fikse mujore që pasqyron Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave që ofrohen në këtë mënyrë, duke marrë parasysh sasinë e llogaritur të Mbeturinave të Ngurta Komunale të gjeneruara nga Konsumatori Komercial që merr shërbimet;
 - (ii) Konsumatorët Komercial që marrin shërbimet individuale nëpërmes të Kontejnerëve Komercial që janë të dedikuar veçanërisht për ta ose përmes ndonjë forme tjetër të Shërbimeve për Grumbullimin e

Mbeturinave që është specifike për atë Konsumator duhet të faturohet në bazë të tarifës fikse mujore, ose sipas shpeshtësisë së shërbimeve në muaj, ose sipas numrit të ngarkimeve për muaj ose sipas peshës dhe/ose vëllimit të mbeturinave të ngurta komunale të grumbulluara;

- (c) Tarifat e Shërbimeve për Konsumatorët Institucional duhet të ndahen në dy (2) nën-kategori, respektivisht;
- (i) Konsumatorët Institucional që marrin shërbimet nëpërmes të metodës së Kontejnerëve Komunal në të cilën Kontejnerët Komunal duhet të faturohen me tarifë fikse mujore që pasqyron Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave të ofruara në këtë mënyrë, duke marrë parasysh sasinë e mbeturinave të ngurta komunale të gjeneruara nga Konsumatorët Institucional që pranojnë shërbime;
 - (ii) Konsumatorët Institucional që marrin shërbimet individuale përmes Kontejnerëve Komunal të dedikuar veçanërisht për ta ose përmes cilësdo forme tjetër të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave që është specifike për atë Konsumator, duhet të faturohet në bazë të tarifës fikse mujore, ose në bazë të shpeshtësisë së shërbimeve në muaj, ose në bazë të numrit të ngarkimeve për muaj ose në bazë të peshës dhe/ose vëllimit të mbeturinave të ngurta komunale të grumbulluara.

9.3 Me qëllim të përcaktimit të Tarifave të Shërbimit për Shërbimet e Deponimit të Mbeturinave duhet të ekzistojë një kategori e vetme e Konsumatorëve. Tarifa duhet të llogaritet në bazë të peshës së mbeturinave të ngurta komunale të vendosura në objektet e deponive, të shprehura me ton.

Kapitulli 3 : Metoda për Përlllogaritjen e Tarifave të Shërbimit

Neni 10 Metodat Përlllogaritëse të Tarifave të Shërbimeve

- 10.1 Metoda e preferuar për përlllogaritjen e tarifave është metoda e Kostos Margjinale Afatgjate (“KMA”).
- 10.2 Përderisa Ofruesit e Shërbimeve të Mbeturinave të jenë në pozitë të përdorin metodën KMA, atëherë dy metoda alternative mund të përdoren. Pasi të arrihet mbulimi i plotë i kostos, tarifat do të llogariten për të siguruar Kthimin në Bazën Rregullatore të Kapitalit. Para se të arrihet mbulimi i plotë i kostos, do të përdoret Metoda e Mbulimit të Kostos. Kjo Rregull mbulon vetëm Metodën e Mbulimit të Kostos.
- 10.3 Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave i cili ka dëshirë që të përdorë ndonjë metodë tjetër për llogaritjen e Tarifave të Shërbimit ose të modifikojë cilëndo procedurë për përcaktimin e Tarifave të Shërbimeve të specifikuar në këtë Rregull, duhet të shkruajë një letër Rregullatorit në të cilën do të shpjegoj kërkesën e tij dhe Rregullatori do të përgjigjet me shkrim brenda njëzet (20) ditëve të punës nga data e marrjes së letrës në fjalë, nëse do të pajtohet ose do të refuzojë të bëjë një gjë të tillë dhe do të ofrojë arsyet.
- 10.4 Rregullatori mund të refuzojë Metodën e Mbulimit të Kostos ose cilëndo metodë tjetër dhe të kërkojë të përdoret metoda KMA.

Neni 11 Përcaktimi i Tarifave të Shërbimit

Tarifat e Shërbimit mund të përcaktohen qoftë:

- (a) nga Rregullatori përmes shqyrtimit dhe aprovimit të Aplikacionit për Tarifat e Shërbimit të dorëzuara nga Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave në pajtim me këtë Rregull; ose
- (b) përmes Marrëveshjes për Tarifat e Shërbimit e cila mund të lidhet me Rregullatorin dhe Ofruesin të Shërbimeve të Mbeturinave në pajtim me PJESËN 6 më poshtë.

PJESA III : LLOGARITJA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT ME ANË TË METODËS SË MBULIMIT TË KOSTOS

Kapitulli 4 : Përmbledhje e Procedurave të Llogaritjes së Tarifave të Shërbimit

Neni 12 Hapat për Llogaritjen e Tarifave të Shërbimit për Shërbimet e Mbeturinave

Llogaritjet e Tarifave të Shërbimeve duhet të përbëhet nga hapat si në vijim:

- (a) Hapi 1: Vlerësimi i sasisë së projektuar të mbeturinave të ngurta komunale që do të grumbullohet ose pranohet nga secila kategori e Konsumatorëve (Kapitulli 2);
- (b) Hapi 2: Vlerësimi i kostove totale vjetore të projektuara që shkaktohen direkt ose indirekt në ofrimin e Shërbimeve të Mbeturinave (Kapitulli 3);
- (c) Hapi 3: Vlerësimi i të hyrave të nevojshme nga operimet (Kapitulli 4);
- (d) Hapi 4: Përkufizimi i strukturës së Tarifave të Shërbimit që i propozohet Rregullatorit (Kapitulli 5);
- (e) Hapi 5: Konfirmimi që të hyrat e vlerësuara nga operimet duhet të jenë të nevojshme për të mbuluar kostot e vlerësuara të ofrimit të shërbimeve (Kapitulli 6).

Kapitulli 5 : Vlerësimi i Sasisë së Projektuar të Mbeturinave që Duhet të Procesohet

Neni 13 Vlerësimi i Sasisë së Projektuar të Mbeturinave që Duhet të Procesohet

- 13.1 Ofruesit e Shërbimeve të Mbeturinave duhet të vlerësojnë sasinë vjetore të mbeturinave që do të grumbullohen në bazë të dhënave që i kanë mbi grumbullimin dhe deponimin e mbeturinave të regjistruara në vitet e mëparshme por me projeksion i cili bazohet në trendet e njohura, studimet dhe hulumtimet.
- 13.2 Ofruesit e Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave duhet të vlerësojnë sasinë totale të mbeturinave për secilën kategori të Konsumatorëve.
- 13.3 Projeksionet për secilin vit duhet të dakordohen në mes Ofruesve të Shërbimit të Mbeturinave dhe Ofruesit e Shërbimeve të Deponimit të Mbeturinave.

Kapitulli 6 : Vlerësimi i Kostove Totale të Projektuara Vjetore të Ofrimit të Shërbimeve

Neni 14 Komponentët e Kostove të Ofrimit të Shërbimeve

- 14.1 Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave duhet të përdorë të dhënat e kostove historike të marra nga regjistrat e kontabilitetit, të cilat kryhen, organizohen dhe mbahen në

pajtim me Standardet e Kontabilitetit të Kosovës dhe tendereve për furnizime dhe shërbime të ngjashme, për të llogaritur në bazë vjetore:

- (a) kostot e pritura operative ;
- (b) kostot e shërbimit të borxhit;
- (c) provizionin për Llogaritë e Arkëtueshme të Pa-mbledhshme për një (1) vit;
- (d) kostot kapitale.

14.2 Kostoja totale e ofrimit të shërbimeve të mbeturinave në pajtim me Nën-nenin 14.1, duhet të kalkulohet në përputhje me dispozitat e këtij Kapitulli.

Neni 15 Llogaritja e Kostove Operative

15.1 Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave duhet të përfshijë në llogaritjen e kostove të veta operative, pa kufizime si vijon:

- (a) të ardhurat dhe kontributet e sigurimit social dhe shpenzimet e ndërlidhura me pagat;
- (b) pagesat nga qiraja për cilëndo pronë ose asete të marrë me qira;
- (c) energjinë dhe karburantet;
- (d) riparimet dhe mirëmbajtje;
- (e) materialet lidhur me ofrimin e shërbimeve;
- (f) shërbimet kontraktuale;
- (g) kostot e sigurimit;
- (h) Taksën Vjetore të Licencës të pagueshme Rregullatori;
- (i) të gjitha ngarkesat që lidhen drejtpërdrejt me deponimin e mbeturinave të ngurta komunale në Objektin e Licencuar për Deponim (për Ofruesit e Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave);
- (j) të gjitha taksat për licenca dhe leje që kërkohen nga autoritetet tjera ligjore në Kosovë për arsyet që lidhen me të drejtën e Ofruesit të Shërbimeve të Mbeturinave për të ofruar shërbime të mbeturinave; dhe
- (k) kostot tjera operative që aplikohen për ofrimin e shërbimeve ose sipas kërkesës në pajtim me shtojcat të kësaj Rregulle, ose që kohë pas kohe mund të konsiderohen nga Rregullatori si kosto operative që janë shkaktuar në mënyrë të arsyeshme.

15.2 Kostot operative duhet të bazohen në të dhënat aktuale të marra nga Sistemi Aktual i Kontabilitetit të krijuar në pajtim me Standardet e Kontabilitetit të Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe sipas nevojës edhe tenderet për furnizime, shërbime dhe punë të ngjashme. Aty ku ky sistem nuk është në funksion, kostot duhet të llogariten nga llogaritë (kontabiliteti) ekzistuese ose nga të dhënat e regjionit.

Neni 16 Kostot që Përrjashtohen nga Përllogaritja e Kostove Operative

16.1 Me qëllim të vendosjes së Tarifave të Shërbimit me anë të metodës së Mbulimit të Kostos, kostot e amortizimit nuk duhet të përfshihen në përllogaritjen e kostove operative.

16.2 Të gjitha kalkulimet e kostove operative duhet të përjashtojnë Tatimin mbi Vlerën e Shtuar të aplikueshëm në Kosovë përveç rasteve që cilado prej shumave të atij tatimi legalisht nuk është i zbritshëm nga shuma e atij tatimi për të cilin Ofruesi i

Shërbimeve të Mbeturinave kërkohet të paguajë tek autoritetet përkatëse të administratës tatimore kohë pas kohe.

- 16.3 Të gjitha kalkulimet e kostove operative duhet të mos përfshijnë çfarëdo tatime tjera indirekte të cilat në mënyrë legale mund të iu ri-ngarkohen Konsumatorëve ose të cilat në mënyrë legale janë të zbritshme nga shuma e tatimit për të cilin nga Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave kërkohet që kohë pas kohe të paguajë tek autoritetet përkatëse të administratës tatimore.
- 16.4 Vlera e gjobave dhe dënimeve e paguar nga Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave për shkeljet e ligjeve, rregulloreve dhe rregullave të lëshuara dhe/ose të zbatueshme nga Rregullatori dhe/ose nga ndonjë autoritet tjetër publik dhe/ose organ qendror dhe/ose lokal i Kosovës, duhet të përjashtohen nga cilido kalkulim i kostove operative.
- 16.5 Kostot e personelit, kemikaljet, materialet dhe furnizimet, faturat dhe cilatdo kosto operative të paguara nga qeveria ose donatori si subvencion ose grant nuk duhet të përfshihen në kalkulimin e Tarifave të Shërbimit por mund të përdoren si të dhëna referuese për vlerësimin e kostove.
- 16.6 Rregullatori gjithashtu mund të përcaktojë që, kostot të cilat nuk janë të pranueshme për tatimet në fitim dhe/ose tatimet mbi të ardhurat personale në pajtim me ligjet tatimore që janë në fuqi në Kosovë, gjithashtu do të mos përfshihen në përlllogaritjen e kostove operative.

Neni 17 Kostot e Shërbimit të Borxhit

- 17.1 Kurdoherë që është e aplikueshme, Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave duhet të përfshijë kostot e financimit dhe kostot tjera financiare që ndërlidhen me shërbimet e borxheve. Këto kosto duhet të përfshijnë si interesin ashtu edhe shlyerjen e kryegjësë.

Neni 18 Llogaritë e Arkëtueshme të Pa-mbledhshme

- 18.1 Me qëllim të përcaktimit të Tarifave të Shërbimit për cilindo vit të caktuar, Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave do të lejojë një shumë të llogaritur si përqindje e caktuar e shumës së Llogarive të Arkëtueshme, që lidhet direkt me ofrimin e shërbimeve për të cilat Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave është i licencuar, në fund të vitit fiskal para vitit për të cilin Tarifat e Shërbimit janë duke u përcaktuar.
- 18.2 Sa i përket vlerësimin të provizionit për borxhet e këqija, secili Ofrues i Shërbimeve duhet të vendos politika dhe procedura, të aprovuara nga Bordet e Ofruesve të Shërbimeve dhe Auditorëve të Pavarur, në pajtim me SKK ose SNRF, cilido që është i zbatueshëm. Këto politika dhe procedura duhet të demonstrojnë në mënyrë të qartë masat dhe veprimet e planifikuara që do të ndërmerren nga Ofruesi i Shërbimeve për ngritjen e shkallës së arkëtimit dhe duhet t'i dorëzohen Rregullatorit me secilin Aplikacion për Tarifat e Shërbimit.
- 18.3 Shuma e llogarive të arkëtueshme të pa-mbledhshme të deklaruara si kosto të shërbimit duhet të propozohen nga Ofruesi i Shërbimeve në Aplikacionin e Tarifave të Shërbimit, në bazë të kërkesave të lartpërmendura. Duke u bazuar në mendimin e tij, Rregullatori ka të drejtën të bëjë ndryshime në shumën e propozuar nga Ofruesi i Shërbimeve për aprovim të tarifave.
- 18.4 Përqindja e aplikueshme në pajtim me Nenin 17.1 duhet të jetë e atillë siq përcaktohet nga Rregullatori kohë pas kohe.

Neni 19 Shpenzimet Kapitale

- 19.1 Secili Ofrues i Shërbimeve të Mbeturinave gjatë planifikimit të shpenzimeve të tija kapitale duhet të bëj dallimin në mes të:
- (a) shpenzimeve kapitale me të cila synohet riparimi ose zëvendësimi i kapacitetit ekzistues të kapitalit të cilat do të jenë të përfshira në Planin për Mirëmbajtjen Kapitale; dhe
 - (b) shpenzimeve kapitale me të cilat synohet zgjerimi i kapacitetit ekzistues kapital, përmirësimi i kualitetit të shërbimit ose ofrimi i shërbimeve për një numër më të madh të konsumatorëve të cilat duhet të jenë të përfshira në Planin për Përmirësimet Kapitale.
- 19.2 Të dy planet të përcaktuara në Nenin e mëparshëm duhet të prodhohen në përputhje me formatin e përcaktuar në Shtojcën 3a, të kësaj Rregulle dhe duhet të mbulojnë periudhën pesë vjeçare dhe të azhurnohen çdo vit.
- 19.3 Shuma totale e shpenzimeve kapitale e lejueshme për përdorim në kalkulimin e Tarifave të Shërbimit duhet të jetë e barasvlershme me shumën e shpenzimeve të parapara të projekteve të përfshira në Planin për Mirëmbajtje Kapitale dhe në Planin për Përmirësimet Kapitale për vitin përkatës.
- 19.4 Vlera e cilit do prej asetëve qoftë të blerë ose të pranuar si donacion nga donatorët nuk duhet të përfshihet në përlllogaritjet e Tarifave të Shërbimit por mund të përdoret si e dhënë referuese për kostot.
- 19.5 Cilat do shpenzime kapitale të financuara përmes granteve nga donatorët nuk duhet të përfshihet në kalkulimet e Tarifave të Shërbimit por mund të përdoren si të dhëna referuese për kostot.
- 19.6 Rregullatori mund të kërkojë arsyetim financiar për shpenzimet kapitale, për shembull në formë të analizës të rrjedhjes së parasë dhe do të vendos qoftë t'i aprovojë ose të mos i aprovojë të gjitha ose ndonjë komponent të shpenzimeve kapitale për qëllime të përlllogaritjes së Tarifave të Shërbimit.

Neni 20 Përmbledhja e Kostove

- 20.1 Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave do të përmbledhë kostot lidhur me ofrimin e Shërbimeve të Mbeturinave sipas mënyrës të ofruar në Shtojcën 3a ose 3b të kësaj Rregulle.

Neni 21 Aktivitetet e Parregulluara

- 21.1 Ofruesit të Shërbimeve nuk i lejohet të subvencionojë cilat do aktivitete të parregulluara nga të hyrat që i nxjerrë nga aktiviteti i tij i rregulluar.
- 21.2 Nëse Ofruesi i Shërbimeve është në gjendje të shpërndajë kostot në mënyrë të saktë për aktivitetet e parregulluara atëherë këto kosto duhet të përjashtohen nga Përmbledhja e përshkruar në Nenin 20; nëse nuk është në gjendje atëherë të hyrat duhet të zbriten nga aktivitetet e parregulluara.

Neni 22 Subvencionet dhe Grantet

- 22.1 Të gjitha kostot e financuara nga subvencionet dhe grantet duhet të përjashtohen nga përmbledhja e kostove të përshkruar në Nenin 20.

Kapitulli 7 : Vlerësimi i Të Hyrave të Nevojshme nga Operimet

Neni 23 Vlerësimi i Të Hyrave të Nevojshme nga Operimet

- 23.1 Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave duhet të përcaktojë të hyrat e nevojshme nga operimet duke shtuar kostot e operimeve plus kostot për shërbimin e borxhit plus provizionin për llogaritë e arkëtueshme të pa-mbledhshme plus shpenzimet kapitale minus të hyrat nga neni 20 dhe 21.
- 23.2 Kurdo që është e mundshme Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave duhet të kalkulojë të hyrat e nevojshme nga operimet për secilën kategori të Konsumatorëve.

Kapitulli 8 : Përkufizimi i Strukturës së Tarifave të Shërbimit që i Propozohet Rregullatorit

Neni 24 Kalkulimi i të Hyrave të Vlerësuara

- 24.1 Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave do të vlerësojë të hyrat për secilën kategori të Konsumatorëve si të rradhitura në Nenin 9.1, nëse është e aplikueshme, në bazën e tarifës fikse mujore, dhe/ose shpeshtësinë e shërbimit, dhe/ose numrin e ngarkesave në muaj dhe/ose peshën dhe/ose vëllimin e mbeturinave të ngurta komunale që pritet të grumbullohen ose cilit do kombinim nga këto dhe duhet të i dokumentojë ato llogaritje të kalkuluara dhe të i dorëzojë ato si dokumente të bashkangjitura në Aplikacionin e tij për Tarifa të Shërbimit.
- 24.2 Kurdoherë që është e mundshme, Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të merr parasysh sasinë e mbeturinave të ngurta komunale që është gjeneruar ose transportuar ose e deponuar varësisht si mund të gjindet në shënimet nga e kaluara.
- 24.3 Ofruesi i Shërbimeve për Deponimin e Mbeturinave duhet të vlerësojë të hyrat nga kategoritë ndryshme të konsumatorëve si të përfshira në Nenin 9.1, në bazë të peshës ose vëllimit që pritet të deponohet dhe ato kalkulime të vlerësuara duhet të dokumentohen dhe të dorëzohen si dokumente të bashkangjitura në Aplikacionin e tij për Tarifa të Shërbimit.

Kapitulli 9 : Konfirmimi që të hyrat e vlerësuara nga operimet do të jenë të mjaftueshme për mbulimin e kostove të vlerësuara për ofrimin e shërbimeve

Neni 25 Konfirmimi i Mjaftueshmërisë së të Hyrave të Vlerësuara për të Mbuluar Kostot e Vlerësuara për Ofrimin e Shërbimeve

- 25.1 Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave duhet të konfirmojë nëse të hyrat e parapara nga operimet do të tejkalojnë ose barazohen me shumën totale të kostove operative për vitin përkatës.

PJESA IV : SHQYRTIMI DHE APROVIMI I APLIKACIONEVE PËR TARIFA TË SHËRBIMIT

Kapitulli 10 : Aplikimi për Tarifa të Shërbimit, Shqyrtimi dhe Aprovimi nga Rregullatori

Neni 26 Aplikimi për Tarifa të Shërbimit

- 26.1 Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave duhet të dorëzojë aplikacionin për Tarifa të Shërbimit duke përdorur formatin e dhënë në Shtojcën 1 të kësaj Rregulle ose siç ofrohet ndryshe nga Rregullatori kohë pas kohe.
- 26.2 Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave duhet të dorëzojë Aplikacionin për Tarifat e Shërbimit, të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve, të evidentuar me anë të letrës përcjellëse, të nënshkruar nga autoriteti relevant.
- 26.3 Në mungesë të Aplikacionit për Tarifa të Shërbimit, ose dështimit të Ofruesit të Shërbimeve të Mbeturinave të dorëzojë të dhënat dhe informacionet e kërkuara, Rregullatori do të vazhdojë me vendosjen e Tarifave të Shërbimit duke marrë si bazë kostot dhe nivelet e performancës, ngjashëm me ato të Ofruesve të Shërbimeve të Mbeturinave në Kosovë ose me anë të supozimeve që mund të konsiderohen të arsyeshme.

Neni 27 Shqyrtimi i Aplikacionit të Tarifave të Shërbimit nga ana e Rregullatorit

- 27.1 Rregullatori duhet të konfirmojë nëse Aplikacioni për Tarifat e Shërbimit është në pajtim me kushtet e kësaj Rregulle dhe të vlerësojë Aplikacionin për Tarifat e Shërbimit, siç është përcaktuar në këtë Nen.
- 27.2 Rregullatori do të vlerësojë Aplikacionin për Tarifa të Shërbimit sipas hapave vijues:
- (a) Kryen shqyrtimin e kompletueshmërisë administrative lidhur me informacionet dhe dokumentet e kërkuara;
 - (b) Verifikon nëse Tarifat e propozuara të Shërbimit janë në pajtueshmëri me parimet e përgjithshme të paraqitura në Nenin 7;
 - (c) Verifikon nëse Tarifat e propozuara të Shërbimeve janë kalkuluar në përputhshmëri me kërkesat të kësaj Rregulle; dhe
 - (d) Vë vendos nëse objektivat e performancës teknike dhe financiare janë arritur ose pritjet të arrihen brenda afateve të vendosura ashtu siç është vendosur apo arritur në pajtim me Rregullatorin për arritjen e minimumit të Standardeve të Shërbimeve dhe treguesve kyç të përmbushjes të specifikuar në Rregullat përkatëse, siç lëshohen nga Rregullatori;
- 27.3 Gjatë aprovimit të kërkesës për përcaktimin e Tarifave të Shërbimit të parashtruar nga Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave, Rregullatori duhet të aprovojë aplikacionin e Tarifave në bazë të pritjeve të drejta të efijencës. Si bazë mund të jetë procesi i krahasimit (benchmarking).

Neni 28 Aprovimi i Tarifave të Shërbimit

- 28.1 Në bazë të kriterëve të përcaktuara në Nenin 27, Rregullatori duhet të aprovojë me shkrim Aplikacionin për Tarifa të Shërbimeve me apo pa ndryshime, me anë të lëshimit të Urdhërësës për Tarifat e Shërbimit.

- 28.2 Pasi të jenë aprovuar, Tarifat e Shërbimit do të mbeten të pandryshuara për një vit, mirëpo korrigoimet duhet merren parasysh në mënyrë të veçantë nëse Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave kërkon korrigoim në bazë të asaj që kostot e tija totale të jenë rritur mbi nivelin e aprovuar në Urdhëresën për Tarifat e Shërbimit ose nëse paraqitet çfarëdo rasti i jashtëzakonshëm i cili sipas mendimit të Rregullatorit ka ndikim në Tarifa.

PJESA V : KOHËZGJATJA, KORRIGJIMI DHE RISHIKIMI I TARIFAVE TË SHËRBIMIT

Kapitulli 11 : Kohëzgjatja e Tarifave të Shërbimit

Neni 29 Kohëzgjatja e Tarifave të Shërbimit

- 29.1 Rregullatori duhet të aprovojë Tarifat e Shërbimit për një kohëzgjatje minimale prej një (1) viti kalendarik dhe maksimum prej pesë (5) viteve kalendarike.
- 29.2 Rregullatori duhet të njoftojë me shkrim të gjithë Ofruesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave për obligimin e tyre të dorëzojnë Aplikacionin për Tarifa të Shërbimit që tregon periudhën e kohëzgjatjes së Tarifave të Shërbimit siç është përcaktuar.
- 29.3 Tarifat e Shërbimit për periudhën e parë pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle duhet të vendosen për një vit kalendarik.
- 29.4 Nëse tarifat aprovohen për më shumë se një vit, përqindja vjetore e rritjes së llogaritur në bazë të inflacionit dhe përshtatjet e eficiencës do të aprovohet.

Kapitulli 12 : Korrigoimet e Tarifave të Shërbimit

Neni 30 Kërkesat për Korrigoimin e Tarifave të Shërbimit

- 30.1 Me rastin e shfaqjes së rrethanave të jashtëzakonshme të cilat nuk kanë mundur racionalisht të parashikohen gjatë dorëzimit të Aplikacionit për Tarifa të Shërbimeve, Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave në çdo kohë mund të dorëzojë tek Rregullatori kërkesën me shkrim për korrigoime Tarifave të Shërbimit, para përfundimit të periudhës për të cilën janë aprovuar Tarifat e Shërbimit duke ndjekur procedurat e përcaktuara me këtë Rregull.
- 30.2 Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave duhet të ofrojë të dhënat e Performancës teknike dhe financiare të cilat e karakterizojnë performancën, duke përfshirë nivelin e objektivave për përmirësimin e performancës të miratuar në pajtim me Rregullatorin për periudhën që mbulohet nga Tarifat e Shërbimeve në fuqi, dhe e cila i justifikon korrigoimet e kërkuara për Tarifat e Shërbimit në formë që aprovohet, përmirësohet dhe/ose plotësohet nga Rregullatori kohë pas kohe.
- 30.3 Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave duhet të ofrojë një përmbledhje të strukturës së propozuar së Tarifave të korrigjuara të Shërbimit në formë që përcaktohet nga

Rregullatori në shtojcën e kësaj Rregulle ose nëse ndryshe përcaktohet nga Rregullatori kohë pas kohe.

- 30.4 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të ofrojë një arsyetim të qartë në lidhje me korrigjimin e propozuar të Tarifave të Shërbimit.

Neni 31 Aprovimi i Procedurave për Korrigjimin e Tarifave të Shërbimeve

- 31.1 Rregullatori duhet të konfirmojë se kërkesa për Korrigjimin e Tarifave të Shërbimit është në pajtim me këtë Rregull dhe ta vlerësoj dhe ti përgjigjet brenda dyzetepesë (45) ditëve të punës nga data në të cilën Rregullatori ka pranuar atë kërkesë me shkrim.
- 31.2 Rregullatori do të vlerësoj kërkesën për Korrigjimin e Tarifave të Shërbimit sipas hapave në vijim:
- (a) Verifikon nëse dispozitat, kushtet dhe rrethanat që arsyetojnë çfarëdo korrigjimi të Tarifave të Shërbimit janë përmbushur;
 - (b) Verifikon nëse si rezultat i korrigjimeve të propozuara, Tarifat e Shërbimit janë ende në pajtueshmëri me parimet e përgjithshme të dhëna në Nenin 7;
 - (c) Verifikon nëse përshtatjet e propozuara në Tarifat e Shërbimit janë llogaritur sipas kërkesave të kësaj Rregulle;
 - (d) Përcakton nëse objektivat e përmirësimit të performancës, duke përfshirë pa kufizim, objektivat që kanë të bëjnë me performancën të vendosura për përmirësimin e Standardeve të Shërbimit janë arritur brenda afatit të përcaktuar kohor, siç është përcaktuar apo është arritur pëlqimi nga Rregullatori kohë pas kohe;
- 31.3 Nëse kërkesa për Korrigjimin e Tarifave të Shërbimit dështon të përmbush procesin e vlerësimit siç është e përcaktuar në këtë Rregull, ajo do të kthehet Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave bashkë me arsyetimin e mos aprovimit.
- 31.4 Nëse janë përmbushur kriteret e vlerësimit, Rregullatori duhet të aprovojë me shkrim Aplikacionin për Tarifa të Shërbimeve duke lëshuar Urdhëresën për Tarifa.

Neni 32 Refuzimi i Korrigjimit të Tarifave të Shërbimit

Rregullatori mund të refuzojë të aprovojë kërkesën për korrigjimin e Tarifave të Shërbimit të dorëzuar nga Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave për arsyet si vijon:

- (a) Kur Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave i cili aplikon për atë Korrigjim të Tarifave të Shërbimit dështon për të dhënë informacionin e kërkuar brenda afatit kohor të caktuar;
- (b) Kur vlerësohet se kërkesa është e tepruar në lidhje me shërbimet e mbeturinave që ofrohen ose që kanë ndërmend të ofrohen;
- (c) Kur konsatohet se Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave ka dështuar tërësisht ose pjesërisht të plotësojë Standardet e Shërbimit të krijuara nga Rregullatori për Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave në Kosovë;
- (d) Kur Aplikuesi dështon për të kontrolluar kostot e veta Operative dhe/ose cilat do të hyra tjera përkatëse për vendosjen e Tarifave të Shërbimit brenda kufijve të dhënë që konsiderohen si të arsyeshëm ose të pranueshëm nga ana e Rregullatorit.

Kapitulli 13 : Shqyrtimi i Tarifave të Shërbimit

Neni 33 Rishikimi i Tarifave shumëvjeçare të Shërbimit

- 33.1 Kur Tarifat e Shërbimit janë të vendosura për një kohëzgjatje që tejkalon një (1) vit kalendarik, Rregullatori duhet të qartësojë në Urdhëresën për Tarifat e Shërbimit me të cilën aprovohen Tarifat e Shërbimit, kriteret që duhet të ndiqen dhe procedurat për rishikimin vjetor të Tarifave të Shërbimit.
- 33.2 Rregullatori mund të vendos vet ose për çfarëdo arsye të zgjas periudhën e aprovimit të tarifave ekzistuese për më shumë se 6 muaj nga data e skadimit të tarifave me kusht që Ofruesve të Shërbimeve t'iu jepet njoftimi prej 20 ditëve të punës mbi vendimin që të zgjatet periudha e tarifave ekzistuese dhe të shpjegohen plotësisht arsyet.
- 33.3 Kriteret që duhet të ndiqen nga ana e Rregullatorit për shqyrtimin e Tarifave të Shërbimit të aprovuara për kohëzgjatjen e periudhës që tejkalon një (1) vit kalendarik, duhet të përfshijnë pa kufizime, sa vijon:
- (a) Ndikimet e inflacionit në vitin e parë të aplikimit të Tarifave të aprovuara të Shërbimit duke përdorur indeksin përkatës zyrtar të inflacionit të publikuar nga autoritetet kompetente publike të Kosovës;
 - (b) Ndikimet e mundshme të inflacionit të vlerësuar për vitet pasuese duke përdorur indeksin përkatës zyrtar të inflacionit të publikuar nga autoritetet kompetente të Kosovës;
 - (c) Progresin e bërë nga Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave në arritjen dhe ngritjen në nivel më të lartë të Standardeve të Shërbimit;
 - (d) Aspektet tjera teknike, ekonomike dhe financiare të performancës së Ofruesit të Shërbimeve të Mbeturinave siç janë rehabilitimi i aseteve të përdorura për ofrimin e shërbimeve të mbeturinave, rritja e numrit të konsumatorëve që u ofrohen shërbimet, rritja e numrit të popullatës në Zonën e Shërbimit, rritja e shkallës së faturimit dhe arkëtimit të faturave dhe kriterëve tjera përkatëse, duke përfshirë edhe ato mbi Treguesit Kyç të Performancës të përcaktuara nga Rregullatori (shembuj lidhen me Ofruesit e Shërbimeve të Mbeturinave);
 - (e) Kostot përkatëse për ngritjen në nivel të më të lartë të mbrojtjes së shëndetit publik, mbrojtjes së mjedisit dhe standardeve të planifikimit hapësinor;
 - (f) Variacionet në nivelin e satisfacionit të Konsumatorëve të anketuar nga Rregullatori ose entitetet tjera që drejtojnë vlerësimet se sa janë të kënaqur Konsumatorët me shërbimet e ofruara;
 - (g) Cilat do fakte tjera ose tregues të natyrës objektive siç janë performanca që ka të bëjë me Ofruesin e Shërbimeve të Mbeturinave të matur përmes krahasimit kundrejt Ofruesve të Shërbimeve të Mbeturinave të vendosur brenda dhe jashtë Kosovës ku madhësia, niveli i zhvillimit, resurset, numri i Konsumatorëve dhe karakteristikat tjera me rëndësi e bëjnë të mundur krahasimin e Performancës së tyre me atë të ofruar nga Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave.

PJESA VI : MARRËVESHJET PËR TARIFA TË SHËRBIMEVE

Kapitulli 14 : Negocimi dhe Lidhja e Marrëveshjes për Tarifa të Shërbimeve

Neni 34 Marrëveshja për Tarifa të Shërbimeve

- 34.1 Rregullatori mund të lidhë marrëveshjen me shkrim me cilindo Ofrues të Shërbimeve të Mbeturinave me qëllim të ndryshimit, modifikimit, dhe/ose plotësimit të cilat do Tarifave të Shërbimit të krijuara nën këtë Rregull.
- 34.2 Marrëveshja për Tarifat e Shërbimit mund të lidhet në cilat do kushte të dhëna paraprëse të përcaktuara nga Rregullatori dhe të propozuara te Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave, duke përfshirë, pa kufizime, lidhjen e marrëveshjeve tjera obliguese me Ofruesin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave për:
- (a) Lëshimin, përtëritjen, zgjerimin, ndryshimin, modifikimin dhe plotësimin e Licencës për Shërbime;
 - (b) Lëshimin, përtëritjen, zgjerimin, ndryshimin, modifikimin, dhe plotësimin e Standardeve të Shërbimit;
 - (c) Zgjerimin e shtrirjes territoriale të Zonës së Shërbimit për Ofruesit e Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave;
 - (d) Rritjen e numrit të Konsumatorëve të cilëve iu ofrohen Shërbimet nga Ofruesit e Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave;
 - (e) Vendosjen, ndryshimin, zgjerimin, modifikimin dhe/ose plotësimin e cilat do dispozitave lidhur me Konsumatorin që janë paraqitur në Rregullën mbi Kartën e Konsumatorit të lëshuar, ndryshuar, modifikuar dhe/ose plotësuar nga Rregullatori kohë pas kohe dhe të cilat mund të kenë ndikim në tarifat e Shërbimit për Ofruesit e Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave.
- 34.3 Për mënjanimin e dyshimit, Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave ka të drejtë por jo obligim të i propozojë Rregullatorit të lidhë Marrëveshjen për Tarifat e Shërbimeve në pajtim me dispozitat e Nenit 35.

Neni 35 Negociatat e Marrëveshjes për Tarifa të Shërbimit

- 35.1 Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave që dëshiron të lidhë Marrëveshje për Tarifat e Shërbimeve duhet të dorëzojë kërkesën me shkrim tek Rregullatori duke kërkuar hapjen e negociatave për lidhjen e marrëveshjes së tillë duke i ofruar arsyet përse konsideron se interesi publik, të drejtat e tij legjitime si dhe pritjet ligjore do të shërbeheshin më së miri nëse Rregullatori do të pranonte të lidhë Marrëveshjen për Tarifa të Shërbimit.
- 35.2 Brenda pesë (5) Ditëve të Punës nga data e marrjes së komunikimit të referuar në Nenin 34.1, Rregullatori duhet të përgjigjet me shkrim edhe në rastin kur ai miraton për të hyrë në negociatave për Marrëveshjen për Tarifa të Shërbimit edhe kur refuzon të bëjë një gjë të tillë.
- 35.3 Nëse Rregullatori vendos të refuzojë fillimin e negociatave për lidhjen e Marrëveshjes për Tarifa të Shërbimit, duhet të jap edhe arsyet e veta për atë refuzim.
- 35.4 Nëse Rregullatori pajtohet të fillojë negociatat për të lidhë Marrëveshjen për Tarifa të Shërbimit, gjithashtu duhet ti jep Ofruesit të Shërbimeve të Mbeturinave një periudhë kohore të duhur, në çfarë do rasti jo më pak se tridhjetë (30) ditë të punës,

për të i lejuar Ofruesit të Shërbimeve të Mbeturinave të dorëzojë tek Rregullatori projektin e Marrëveshjes për Tarifa të Shërbimit.

- 35.5 Brenda dhjetë (10) ditëve të punës nga marrja e projekt Marrëveshjes për Tarifa të Shërbimit, Rregullatori duhet të njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të Mbeturinave për caktimin e takimit të parë për të filluar negociatat për atë marrëveshje.
- 35.6 Rregullatori mund të përcaktojë periudhën maksimale kohore për përfundimin e negociatave për lidhjen e Marrëveshjes për Tarifat të Shërbimit e cila nuk mund të jetë më pak se njëzet (20) ditë të punës nga data e takimit të parë negociues të caktuar në pajtim me Nenin 34.5.
- 35.7 Për mënjanimin e çdo dyshim, Rregullatori ka të drejtë por nuk është i obliguar të lidhë Marrëveshje për Tarifa të Shërbimit, kështu që, qoftë refuzimi i tij për hapjen e negociatave për të lidhë atë marrëveshje ose çfarëdo dështimi i kompletimit të suksesshëm të negociatave në fjalë, konsiderohen si vendime kontraktuale dhe jo si akte administrative që i nënshtrohen cilitdo shqyrtimi administrativ dhe/ose juridik.

Neni 36 Lidhja e Marrëveshjes për Tarifat e Shërbimit

- 36.1 Në rast të përfundimit me sukses të negociatave të drejtuar në pajtim me Nenin 35, Rregullatori dhe Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave duhet të lidhin me shkrim Marrëveshjen për Tarifat e Shërbimeve.
- 36.2 Marrëveshja për Tarifat e Shërbimeve duhet të nënshkruhet në tri versione në secilën prej gjuhëve zyrtare që përdoren në Kosovë si në vijim:
- (a) Shqip;
 - (b) Serbisht;
 - (c) Anglisht.
- 36.3 Në rast të mospërputhjes të cilit do nga versionet në të cilën është nënshkruar Marrëveshja për Tarifat e Shërbimeve, gjuha Shqipe duhet të merret si bazë.
- 36.4 Përveç për sa ka ta bëjë me cilindo fakt, informacion dhe/ose dokument që mund të konsiderohet që përmban ndonjë informatë të privilegjuar ose konfidenciale që Rregullatori mund të arsyetojë në vendimin me shkrim, Marrëveshja për Tarifa të Shërbimit duhet jetë në dispozicion për publikun me mjetet që përcaktohen nga Rregullatori kohë pas kohe.
- 36.5 Cilat do korrigjime, ndryshime, modifikime ose dispozita plotësuese që i përkasin Marrëveshjes për Tarifa të Shërbimit duhet të kërkojnë pëlqimin e Rregullatorit dhe të Ofruesit të Shërbimeve të Mbeturinave dhe duhet të lidhet me shkrim , të botohen dhe të bëhen publike në pajtim me dispozitat e Nenin 40 të poshtëshënuar.

Kapitulli 15 : Natyra Ligjore dhe Zbatueshmëria e Marrëveshjes për Tarifa të Shërbimeve

Neni 37 Natyra Ligjore dhe Zbatueshmëria e Marrëveshjes për Tarifa të Shërbimeve

- 37.1 Marrëveshja për Tarifa të Shërbimit konsiderohet si kontratë administrative për të gjitha qëllimet e synuara legale. Kështu që Rregullatori është i obliguar të negociojë, të lidhë dhe të ekzekutojë një marrëveshje të tillë me një zbatim strikt të primeve

të përgjithshme ligjore, rregullave dhe procedurave që qeverisin ushtrimin e prerogativave dhe detyrave të autoriteteve publike.

- 37.2 Marrëveshja për Tarifa të Shërbimit, si akt ligjor bilateral është legalisht detyrues, të i zbatueshëm dhe i ekzekutueshëm në pajtim me kushtet e tij për të dy palët dhe mundet të korrigohet, zgjerohet, modifikohet, plotësohet shqyrtohet dhe/ose ndërpritet vetëm në dritën e dispozitave të veta dhe ligjit të aplikueshëm në Kosovë.

Neni 38 Respektimi i Marrëveshjes për Tarifat e Shërbimeve

Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave është i obliguar të respektojë dhe të jetë në pajtueshmëri me Tarifat e Shërbimit në përputhje me kërkesat e kësaj Rregulle:

- (a) Përderisa negociatat për lidhjen e Marrëveshjes për Tarifat e Shërbimit janë të pezulluara deri më datën e hyrjes në fuqi të një marrëveshjeje të tillë;
- (b) Menjëherë me ndërprerjen, anulimin, revokimin dhe/ose skadimin e Marrëveshjes për Tarifa të Shërbimit për sa ka të bëjë me cilat do të drejta dhe obligime që i përmban Marrëveshja për Tarifat e Shërbimeve për të cilat nuk është arritur pëlqimi që të vazhdojnë së ekzistuari kur të pushon të jetë në fuqi dhe efekt të plotë për çfarëdo shkaqe ligjore; dhe

Në çdo pikëpamje kur Marrëveshja për Tarifa të Shërbimit nuk përcakton ndryshe dhe/ose në çdo pikëpamje që nuk parashihet në mënyrë specifike në atë marrëveshje.

PJESA VII : PUBLIKIMI I TARIFAVE TË SHËRBIMIT

Kapitulli 16 : Prezantimi dhe Publikimi i Tarifave të Shërbimit

Neni 39 Prezantimi i Tarifave të Shërbimit

Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave duhet të përmbledhë Tarifat e Shërbimit të aprovuara, të përshtatura dhe/ose të shqyrtuara nga Rregullatori kohë pas kohe.

Neni 40 Publikimi dhe Shpërndarja e Tarifave të Shërbimit

- 40.1 Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave duhet të shpërndajë tek secili Konsumator Tarifat e Shërbimit të aprovuara nga Rregullatori të aplikueshme në kohën kur Konsumatori kompletton Kontratën për Shërbime ose një herë në vit si dokument që i bashkëngjitet Faturës për ofrimin e shërbimeve për grumbullimin e mbeturinave.
- 40.2 Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave duhet të publikojë Tarifat e Shërbimit të aprovuara nga Rregullatori në mënyrën si në vijim:
- (a) në gazeta me qarkullim të gjerë në Zonën e Shërbimit në të cilën duhet të aplikohen ato Tarifa të Shërbimit; dhe
 - (b) publikime në fjalë duhet të përsëriten së paku një herë në javë pas datës në të cilën është bërë publikimi i parë; dhe
- 40.3 Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave do të mbahet përgjegjës i vetëm për publikimin dhe shpërndarjen tek publiku të Tarifave të Shërbimit dhe për të gjitha kostot e lidhur me to.

- 40.4 Rregullatori mund të publikojë tarifavat në cilëndo mënyrë që e konsideron të përshtatshme për publikim dhe njoftim të publikut.

PJESA VIII : ZBATIMI, DËNIMET DHE ANKESAT

Kapitulli 17 : Zbatimi i Kushteve të Tarifave të Shërbimeve

Neni 41 Zbatimi i Kushteve të Tarifave të Shërbimeve

Rregullatori do të monitorojë respektimin e kushteve të Tarifave të Shërbimit të krijuara në këtë Rregull në bazë të:

- (a) raporteve të dërguara nga Ofruesi i Shërbimit të Mbeturinave sipas Neni 41;
- (b) inspektimeve, anketave dhe raporteve të dërguara nga entitetet dhe autoritetet tjera publike.

Kapitulli 18 : Shënime dhe Raportet e Kushteve për Tarifat e Shërbimit

Neni 42 Vendi dhe Disponueshmëria e Shënimeve

Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave do të mbajë shënime të afarizmit, financiare si dhe të kontabilitetit të tij në selinë e tij afarizmit në një mjedis të sigurt dhe të siguruar dhe duhet të jenë në dispozicion të kontrollit gjatë orarit të rregullt të punës me anë të mjeteve të cilat Rregullatori mund të i përcaktojë kohë pas kohe.

Neni 43 Raportet

- 43.1 Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave duhet të përgatisë dhe ti dorëzojë Rregullatorit raporte në formën, përmbajtjen, mënyrën dhe në afatet e përshkruara nga Rregullatori kohë pas kohe.
- 43.2 Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave, jo më vonë se më 31 mars pas fundit të vitit paraprak, duhet ti dërgojë Rregullatorit raportin vjetor në formatin që përshkruhet nga Rregullatori kohë pas kohe.
- 43.3 Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave, jo më vonë se më 15-të të muajit që pason muajt mars, qershor, shtator dhe dhjetor, në baza tremujore do të dorëzojë raportet financiare të pa-audituar në formatin që është në pajtim me standardet e kontabilitetit të pranuar gjërësisht dhe me rregullat e kontabilitetit në fuqi në Kosovë.
- 43.4 Secili Ofrues i Shërbimeve, jo më vonë se më 1 Dhjetor, duhet ti dorëzojë Rregullatorit Planin e Biznesit për vitin e ardhshëm i cili paraprakisht është aprovuar nga Bordi i Drejtorëve;
- 43.6 Secili Ofrues i Shërbimeve, jo më vonë se 31 Mars pas fundit të vitit paraprak kalendarik, duhet t'i dorëzojë Rregullatorit, pakon e pasqyrave financiare në formatin i cili është në pajtim me Standardet e Kontabilitetit të Kosovës ose Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, cilat do që janë të aplikueshme. Këto pasqyra financiare së pari duhet dorëzohen të pa audituar dhe pasqyrat e audituar duhet të dorëzohen pas 30 Qershorit.

Neni 44 Periudha e Mbajtjes së Shënimeve dhe Raporteve

Të gjitha shënimet dhe raportet e parapara në Neni 43 duhet të organizohen dhe të mbahen nga Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave për së paku pesë (5) vite kalendarike nga data kur ato janë përgatitur së pari përveç nëse ndonjë ligj tjetër i aplikueshëm përcakton se ato duhet të mbahen për një periudhë kohore më të gjatë, në të cilin rast periudha e fundit duhet të aplikohet.

Kapitulli 19 : Kundërvajtjet dhe Dënimet

Neni 45 Kundërvajtjet, Dënimet dhe Gjobat

- 45.1 Dështimi për të respektuar cilat do dispozita të Tarifave të Shërbimeve të kësaj Rregulle dhe çfarëdo ngarkese e Konsumatorëve me çfarëdo shuma që nuk janë në pajtim me Tarifat e Shërbimit të aprovuara nga Rregullatori do të paraqes kundërvajtje e cila do të reflektohet me dënimin ose gjobitjen e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave që ka shkaktuar shkelje, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/49 e datës 26 Nëntor 2004, "Mbi Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimit të Ujësjetësimit, Kanalizimit dhe të Mbeturinave".
- 45.2 Gjobat për shkeljen e cilat do dispozitave të Tarifave të Shërbimit që janë të përfshira në këtë Rregull gjithashtu duhet të llogariten dhe të vihen në pajtim me procedurat e krijuara nga Rregullatori kohë pas kohe.

Kapitulli 20 : Ankesat

Neni 46 Ankesat

- 46.1 Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave mund të ankohet tek Komisioni Shqyrtues i themeluar në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/49 te datës 26 Nëntor 2004, *Mbi Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetësimit, Ujërave të Zeza dhe Mbeturinave* të datës 26 Nëntor dhe amendamenteve të bëra me *Ligjin Nr. 03/L-086* të aprovuar më 13 Qershor 2008, ndaj secilit prej vendimeve formale dhe konkrete të ofruara nga Rregullatori mbi cila do çështje, duke përfshirë pa kufizime sa vijon:
- (a) lëshimin, ndryshimin, modifikimin, korigjimin, plotësimin, përtëritjen ose zgjatjen e Tarifave të Shërbimit;
 - (b) revokimin, deklarimin ose përcaktimin ose anulimin e cilat do Tarifave të Shërbimit të përcaktuara nga Rregullatori nën këtë Rregull;
 - (c) vendosjen ose zbatueshmërinë e cilat do kushteve të Tarifave të Shërbimit të parapara nën këtë Rregull;
 - (d) vënien e cila do dënimeve për çfarëdo shkelje të cila do kushteve të Tarifave të Shërbimit ose cila do dispozitave tjera të këtij Rregull.
- 46.2 Ofruesi i Shërbimeve të Mbeturinave gjithashtu mund të ankohet në gjykatat e Kosovës që kanë kompetencë në lidhje me këto çështje, ndaj cila do vendimeve të Komisionit Shqyrtues që janë marrë ndaj çfarëdo vendimeve konkrete të zbatueshmërisë së kësaj Rregulle në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut të referuar në nën-Nenin 46.1. *Mbi Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetësimit, Ujërave të Zeza dhe Mbeturinave* të datës 26 Nëntor dhe amendamenteve të bëra me *Ligjin Nr. 03/L-086* të aprovuar më 13 Qershor 2008.

- 46.3 Me nxjerren e çfarëdo vendimeve konkrete që kanë të bëjnë me zbatueshmërinë e kësaj Rregulle, Rregullatori duhet të informojë Ofruesin e Shërbimeve të Mbeturinave të cilit i drejtohet vendimi detyrues për të drejtat e tij për t'u ankuar në përputhje me këtë Nen.

PJESA IX : TË NDRYSHME

Neni 47 Gjuhët

- 47.1 Kjo Rregull nxjerret dhe publikohet në tri versione të shkruara në gjuhët që përdoren në Kosovë:
- (a) Shqip
 - (b) Serbisht
 - (c) Anglisht
- 47.2 Në rast të ndonjë mos përputhjeje në mes të versioneve në të cilat kjo Rregull është lëshuar, versioni në gjuhën Shqipe do të merret si bazë.

Neni 48 Hyrja në Fuqi

- 48.1 Kjo Rregull do të hyjë në fuqi tridhjetë (30) ditë datës pas lëshimit të saj.

.....

Afrim Lajçi
Drejtör
Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina

PJESA X : SHTOJCAT

SHTOJCA 1

FORMULARI I APLIKIMIT PËR TARIFAT E SHËRBIMIT PËR SHËRBIMET E MBETURINAVE

APLIKACIONI PËR TARIFA TË SHËRBIMIT	
	Data: <input type="text"/>
Emri i Ofruesit të Shërbimeve të Mbeturinave	<input type="text"/>
Numri i Licencës së Shërbimit	<input type="text"/>
Kontakt Adresa	<input type="text"/>
Qyteti	<input type="text"/>
Komuna	<input type="text"/>
Numri i Telefonit	<input type="text"/> ; <input type="text"/>
Personi Kontaktues	<input type="text"/>

SHTOJCA 2

DOKUMENTET E NEVOJSHME QË DUHET TË BASHKANGJITEN NGA APLIKUESI PËR TARIFA TË SHËRBIMIT DHE INSTRUKSIONET

Formulari i Aplikacionit për Tarifa të Shërbimit për Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave të Ngurta dhe tabelat përkatëse për kalkulim siç janë të prezantuara në Shtojcat më poshtë duhet të shoqërojnë dokumentet si në vijim:

1. Letra nga Bordi Mbikëqyrës e nënshkruar dhe vulosur për ZRRUM për Aplikim për tarifën e Shërbimit;
2. Lista aktuale e Tarifave të Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave të Ngurta, Taksat e aplikueshme dhe data e vendosjes;
3. Një kopje të kompletit të fundit të pasqyrave financiare të vërtetuara nga AKM-ja dhe kur është në dispozicion nga çfarë do auditori i pavarur i lëshuar më ose me referencë në vitin në të cilin pasqyrat e bashkangjitura financiare i referohen dhe/ose për Aplikacionin e Tarifave të Shërbimit raportin e fundit financiar të audituar në dispozicion.

Origjinali dhe një kopje e Aplikacionit për Tarifa të kompletuara dhe të nënshkruara qartë janë të kërkuara. Një kopje duhet të mbahet në dokumentacioni e Parashtruesit.

Si origjinali ashtu dhe kopja e Aplikacionit për Tarifa duhet të vërtetohet dhe të nënshkruhet nga Drejtori Menaxhues i Ofruesit të Shërbimeve.

Shtojca 3a ose 3b, sipas nevojës, duhet gjithashtu të përcillet në formën elektronike.

SHTOJCA 3

KËRKESA PËR KORRIGJIM TË TARIFAVE

ARËSYET PËR KORRIGJIMIN E TARIFAVE

Plotëso deklaratat në vazhdim në mbështetje të kërkesës suaj për tarifa.

_____ (the "Ofruesi i Shërbimit") kërkon një përshtatje në tarifat aktuale të vendosura. Informacioni i përmbajtur në këtë aplikacion është bazuar mbas mbarimit të Vitit Testues prej dymbëdhjetë-muaj që përfundon më _____ (data-muaji-viti). Kompania ka pasur të hyra totale operative prej EUR _____, ka shërbyer _____ konsumatorë dhe ka grumbulluar _____ tonë të mbeturinave të ngurta gjatë Vitit Testues.

Kompania është duke kërkuar një rritje/zbritje në të hyra në vlerën EUR _____.

Totali i të hyrave operative vjetore, nëse Kompanisë i është dhënë përshtatja e tarifës, do të jetë EUR _____.

Ofruesi i Shërbimeve është i rregullt në shlyerjen e pagesave të Tatimit mbi pronë – PO/ JO

Ofruesi i Shërbimeve është i rregullt në shlyerjen e pagesave të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar – PO/ JO

Ofruesi i Shërbimeve është i rregullt në shlyerjen e pagesave të faturave të rrymës, ngrohjes qendrore dhe mbeturinave të ngurta – PO/ JO

Ju lutemi të ofroni arsyet në lidhje me kërkesën tuaj për përshtatjen e tarifave me kompletimin e vendeve përkatëse më poshtë. Sipas dëshirës, Kompania mundet të bashkangjit një tregim me shkrim që ka të bëjë me arsyet e tija për përshtatjet e kërkuara të tarifave. Tregimi juaj mundë të përmbledh përpjekjet të bëra nga ndërmarrja për kontrollimin e kostove dhe shpenzimet dhe të zvogëloj vlerën e përshtatjes së tarifës.

Ju lutem shpjegoni ndryshimet në operimet aktuale nga operimet në të kaluarën, të cilat kanë nevojitur përshtatjen e tarifës

Ju lutemi përshkruani përshtatjet e bëra në vlerat të cilat janë të përfshira në këtë aplikacion dhe të cilat ndryshojnë nga vlerat e regjistruara në librat tuaja të kontabilitetit (përshtatjet pro forma)

Ju lutemi shpjegoni faktorët me rëndësi që influencojnë të hyrat dhe shpenzimet tuaja

Ju lutemi diskutoni rritjen apo zbritjen e parashikuar të Konsumatorëve tuaj që pritet të ndodhë brenda dy viteve të ardhshme, vlerën e ndërtimeve të parapara që do të shërbejnë këta Konsumatorë dhe si janë financuar; grupin e Konsumatorëve të shërbyer nga ndërmarrja si p. Sh. Shtëpiak, bizneset e vogla me pakicë, tregtitë e mëdha, etj.

Ju lutem të përshkruani ndërtimet e parapara apo bashkangjiteni kopjen e Planit të Menaxhimit të Aseteve

Ju lutemi përshkruani çfarëdo faktori tjetër që influencon apo ndikon tarifën tuaj që kërkon përshtatje
